

Traduit du français en albanais par le poete Jeton Kelmendi

□

**Biografia: Athanase Vantchev de Thracy**

Athanase Vantchev de Thracy është pa dyshim njëri nga poetët më të mëdhenj bashkëkohës francezë. I lindur më 3 janar 1940, në Haskovo të Bullgarisë, ky poliglot me kulturë të jashtëzakonshme ndjek për shtatëmbëdhjetë vjet me radhë studime të larta në disa nga universitetet më të njohura të Evropës, ku ai fiton njohuri të thella për poezinë botërore.

Athanase Vantchev de Thracy është autor i 28 përmbledhjeve me poezi (të shkruara në varg klasik dhe të lirë), ku ai përdor gjithë spektrin e prozodisë : epopenë, odën, sonetin, bukoliket, idilet, pastoralet, baladat, elegjitë, rondon, satirën, hymin, i pigramin, epitafin etj. Ai ka publikuar gjithashtu një numër monografish si dhe punimin e doktoraturës, Simbolika e dritës në poezinë e Paul Verlaine-it. Në bullgarisht, ai shkruan një studim për shkrimtarin epikurian Plutone, të mbiquajtur Petronius Arbiter elegantiaru, i preferuari i Neron-it, autor i romanit Satirikon, si dhe një studim në gjuhën ruse me titull Poetika dhe metafizika në veprën e Dostojevskit. Duke qenë një njohës shumë i mirë i antikitetit, Athanase Vantchev de Thracy shkruan mjaft artikuj për poezinë greke e latine. Kurse gjatë qëndrimit të tij prej dy vjetësh në Tunizi, ai boton njëra pas tjetrës tri vepra kushtuar dy qytezave punike tuniziane : Monastir-Ruspina – ana e tejudkshme, El-Djem-Thysdrus – i fejuari i kaltërsisë dhe Mozaikët e qytetit të Thysdrus-it.

Ai studion për shumë vite me radhë islamin dhe vendet e Lindjes si Sirinë, Turqinë, Libanin, Arabinë Saudite, Jordaninë, Irakun, Egjiptin, Marokun, Tunizinë, Mauritaninë dhe Taxhikistanin, ku kalon edhe një pjesë të jetës së tij. Në këtë periudhë, ai përshtat në gjuhën frënge veprën historike të Mustafa Tlass-it Zenobie, mbretëresha e Palmyre-it.

Ai qëndron gjithashtu dy vjet në Rusi (1993-1994) për të studiuar poezinë ruse. Përkthyes i një plejade të tërë poetësh, Athanase Vantchev de Thracy është nderuar me shumë çmime letrare e ndërkombëtare, midis të cilëve me Çmimin e Madh Ndërkombëtar të Poezisë Solenzara. Ai është laureat i Akademisë Franceze, anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave, Arteve dhe të Letërsisë, Docteur honoris causa i Universitetit të Veliko Tarnovo-s, në Bullgari, laureat i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, anëtar i P.E.N Club-it francez, i Shoqatës së Shkrimtarëve francezë si dhe i Shtëpisë së Shkrimtarëve dhe të letërsisë në Francë. Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të

huaja.

Vepra poetike:

- Flakërime (1970).
- Hije e marrëzi (1971).
- Polyhymnia (1981)
- Libri i transparencave (1981)
- Orë e Stinë (1981)
- Ti, Virgjëreshë e zjarrit (1985), ribotuar më 2001 dhe 2002
- Oaz, fytyra drite (1986)
- Strofa pentacorde(1986)
- Animula vagula, blandula (1986)
- Sonetet e Damaskut (1987)
- Elozh drite (1987)
- Libër për oktavat (1987)
- Leptis-Minor (sonete romane)
- Përmbi Fjalët (1988)
- Anamnezë (1991), ribotim i zgjeruar(2006)
- Vetmia e Tridhjetë (1992)
- Trallisje, pasuar nga Shkëlqimet (1992)
- Këngë homofonike (1997)
- Zëra të bukur antikë (2000)
- Befas, një drithërimë ëngjëllore (2000)
- Momente përjetësie (2001)
- Anale dhe përshpirtje (2002)
- Epopteia ( Soditje sublime) 2003.
- Elegji (2003)- Ora e Nëntë (2004)
- Mëshirë, o Zot (2005)
- Kështu bëhen njerëzit (2006)
- Dhe deti kthehej në këngë (2007)

I.

## DHEMBSHURI

Carolina di Gregorio-s

Sa i kthjellët është ky mëngjes, e ëmbla ime, Carolina,

Këtë e dinë edhe trishtilat që luajnë

Kukafshehtas me filladin si pëlhurë xixëlluese.

Zëra fëmijësh gjallojnë lumturisht rrugëve

E shpërthejnë si këmbana kristali Në ajrin e tejdukshëm.

E qeshur, ti shtrin nga dritarja krahët e tu Të Të brishtë drejt gëzimit të padukshëm

Nga kraharorët e tyre fërgëllues,

Dhe ndjesitë e tua, nën puthjet e pastërvitura

Të diellit adoleshent

Rezonojnë si kordat  
E harpës!  
Mos u përkul më tepër drejt  
Hapësirës së dritares,  
Engjëlli im i Bukurisë!  
Ti mund të biesh në greminë  
Nga zemra ime, ku vetëm ti,  
Në këtë pranverë të qeshur,  
E veshur me zefir e trëndafilë,  
Mbretëron si Afërditë,  
E madhe, e panënshtuar,  
Perëndeshë e pashoqe  
E Bukurisë, e Dashurisë  
Dhe e Dhembshurisë!

Paris, e martë, më 24 shkurt 2004

II.

## FJALË KALTËRSIE

Stephen-it

« Kërkoj pa pushim sytë e asaj  
Që ishte për mua aq e bukur »

Perandori Wou

Ne e donim detin, valët e qeta të ujit  
Gjelbërimin mahnitës të fushave e kodrinave  
Librin e qetësisë dhe muzikën hyjnore  
Të vargjeve të Teokritit në hije të pemëve lulebardha

Fleurigny – Touques, këtë të martë të 1 janarit 2008

III.

## HYR DHE NDIZE DRITËN

"My God, what is a heart?"

George Herbert-it (1593-1633)

Hyr e ndize dritën dhe qesh ! Kënga e ëmbël e natës pranverore hyn edhe ajo Në shtëpi,  
plot me lule të kuqe e të kaltra.

Përse je kaq e frymëzuar, kaq e lehtë? Përse fustani yt vallëzon nëpër kadifin e qetësisë  
Me një ëndërr lumturie të thurur kaq bukur?  
A ëndërron ti për parfume ngacmuese  
Që t'i bëjnë lëvizjet e tua kundermonjëse  
Dhe perdet të dridhen nga fryma e kohës  
Si fletët që bien nga plepat e vjetër?  
A do ta ndërroje ti aromën e butë të një peme,  
Me fëshfërimën e ndrojtur të qershive?  
E Dashur, sa e dua këtë lumturi  
Që buron prej trupit tënd,  
Si një fllad i ardhur nga deti  
Që shkon drejt pyllit me pisha!  
Hajde, të lutem, të më mësosh  
Artin e harmonisë me dritën e qiellit,  
Gramatikën e dashurisë së bimëve të gjalla,  
Dhe kuptimin e yjeve të ndezur në zemër.  
Jam shumë i lodhur !  
Por shpirti im kërkon të flasë pa pushim  
Gjuhën e virgjër të lëndinave  
Dhe të dëshifrojë fshehtësitë  
E « Tablettes de buis d'Aprononia Avitia ! »  
Më thuaj se me çfarë lloj arti të pashprehur  
Dashuria i zhvendos pa pushim kufijtë  
Ndërsa unë, i harruar në melankolinë time,  
Dëgjoj këngë që më ngjajnë me ato të mëllenjave !  
Thuamë, pra, shpirt im,  
What is a heart ?

Në Paris, këtë të diel të 6 shkurtit, Anno Christi 2005

IV.

### TRI PSHERËTIMA

E çfarë mund t'ju them më qartë se këto fjalë :  
Koha është e mirë në pemishten e paqtë të kumbullave,  
Le të pushojmë këtu, të mbështetur në lëvoren e tyre të butë.

\*

Një grua me freskore fildishi tund flokët e saj  
Nën shiun e petaleve. Ajo këndon. Ajo hesht.  
Çfarë shprehin fjalët e saj ? Çfarë fsheh heshtja e saj e bukur ?

\*

Melodi e heshtur e meshkujve të bletëve,  
Këngë elegjiake e bletëve, përsipër  
Shtëpisë sime, plot me miq që qeshin e më duan.

(Vjersha të shkurtëra nga vëllimi me poezi Momente përjetësie, 2001)

V.

### TI JE MIK I VËRTETË

Ti je, Mik i shkëlqyer, mot që të bën të dridhesh  
Zemër e mendimit dhe shpirt i diturisë,  
Drithmë gjethesh që mbrëmja e dashuruar  
E mbush me puthjet e delirit të saj hyjnor.

E diel, 7 dhjetor 2008

VI.

### BILBILI I MAJIT

Jeton Kelmendit

« Ti e njeh pranverën vetëm nga lulet... »

Paul Graldy

E dëgjoj shumë herët në mëngjes. Këtë zë të mrekullueshëm, këtë harmoni trillesh të mëndafshta, këto shpërthime drite plot me nuanca, këto alegro, largos, kreshendo të përpikta et kaq të fuqishme ! ☐ ☐

Nata është e kthjellët dhe valëzuese si atlas. Ky trup i vogël, fërgëllimë lirike prej ekzaltimit dashuror, dridhet mbi gjethet e buta praverore. Melodia e tij karakteristike, legjendare, e paharruar dhe kënga e tij ngjyrë qelqi vrapojnë si rrëke uji të kulluara duke u drithëruar nëpër pyllin e dendur, nga pema në pemë, nga gëmusha në gëmushë.

□

Gjithëka në këtë natë maji duket sikur është krijuar nga përkëdhelja, tejdukshmëria dhe butësia. Delikati dhe i vogli bilbil! Gjithmonë i padukshëm, i përunjët, fshehur në pendlat e tij prej murgu. E pra, dashuria e tij është muzikë me nota të tejndritshme.

Me fytyrën nën rrezet e hënës, rri e shijoj drithërimat vajtuese të këtij flauti magjik, murmurimat et fyellit rustik, heshtjet e tij të shkurtra dhe nga mallëngjimi mezi mbaj lotët e ngashërimin. Haste qetësie e qlirimi elegjiak, ëndërrime të trallisura plot me mister e shenjtëri.

As mullibardha me zë magjiplotë, as mëllenja muzikante, as zëri i hollë i zogut të lumenjëve, as nqkëlorja e shkathët dhe lozanjare me kokën të mbuluar me tyl të zi, asnjë shpend imitues e fjalëshumë s'mund të matet me artin e paarritshëm të tij.

□

Vetëm zëri i tij prej diamanti derdhet nëpër hije me një bukuri mahnitëse. Vetëm zëri i tij është drithërimë, flatërimë, luhatje e valëzim. Vetëm ai shndërrohet në një këngë të ëmbël.

Dhe pastaj nuk e dëgjojmë më. Zembrën na e pushton një zi e rëndë vjeshore. Ai nisët drejt Afrikës së hareshme, drejt netëve të bukura tropikale, drejt zhegut të tokave të kuqe. Andej ku zemra të tjera rinore, të pastra e të dashuruara e presin me sytë që shkëlqejnë prej ngazëllimit.

VII.

**KAM NEVOJE PER JARGAVANIN**

□

*Në Orlando*

□

E di,  
Dashuria juaj është shënuar virgjërisht  
Me bojë simpatike  
Në faqet e heshtura  
Të kësaj letre!

□

Për të lexuar fjalët e butësisë,  
Unë duhet t'i afrohem

Flakës së zemrës sime  
të fletës,

Po dal si letër  
I shënjosur, i hutuar, i shqetësuar,  
Qartësi e çmuar  
E një rrëfimin!

Duke qenë fllad i lehtë nate  
Kush u dhuroi shqetësim  
Dritave të vogla dridhje  
Xixëllonjash.

Duke qenë rëndesa e lehtë  
E përjetësisë  
Kush dikton në mëngjes  
poemën e tij!

Mik,

Për të lexuar fjalët tuaja  
Kam nevojë për trëndafila  
Që lundrojnë nën aromën e tyre  
shtëpitë në qytet!

Unë kam nevojë për jargavanin  
për të ruajtur jetën tuaj  
në dorën time!

Paris, 5 korrik 2008

□

VIII.

□

ME PAK FJALE









Hënë e plotë,  
falenderim i pakapshëm, i hollë, prekës,  
Trini e ëmbël e butësisë.

Në Fleurigny të Normandisë të dielën më 30 mars, Anno  
Krishtit Tabela e përmbajtjeve (MMVIII)

□

XII.

□

**ZAMBAKË □ DHE TRËNDAFILA NË PARAJSË**

Për dajën tim Aleksandër

□

"Sepse u bëra burrë nën kujtimet e mia"

□ □ □ □ Jose Angel Valente

Hijet e të vdekurve tanë vijnë si vela  
Rrëshqitur mbi ujërat kristal të oqeanit,  
Dhe natën e pamasë grumbullojnë dënesën  
Udhëtimet të tyre të fundit në shtrëngimin astral.

Në Paris, e premte, 2 maj,

Anno Krishtit Tabela e përmbajtjeve (MMVIII)

□

XIII.

□

PESE GJETHET E GESHTENJES

*Për Zitën*

"Në port  
□ fundverës  
kujtimet më shfaqen. "

□□ Akio Bin

I.

*Akira Ogushi t*

Tufë fjalësh mureve -  
tokës së kuqe  
Duke kaluar vitet, duke kaluar stinët.

II.

*Kadokawa Haruki*

Era e vjeshtës  
fishkëllimë me gjethet e kuqe lisi  
Kullon vetmi nga muret.

III.

*Sugawa Yoko*

Një fletë bie qelibartë  
Plep -  
shoqëron një lot,  
Unë jam i vjetër!

IV.

*Nakahara Michio*

Ti lexon me zë të lartë një poemë  
Gjethe gështenjash bien,  
Vjeshta  
në flokët tona.

V.

*Kimura Toshio*

Heshtja e vjeshtës e lëngshme  
Grykët e kuqe përlajnë me hir

kokrrat e rrushit --  
shoku im më ofron  
një dardhë.

Paris, 5 korrik, 2008

□

XIV.

□

**EPIGRAFI - LULE SHËN GJERGJI**

"Frumentum Christi sum..."

Kalimtar, këtu pushon Athanasi-  
Vesa e mëngjesit është qefi i tij,  
Zambakët e luginës, varri i tij --  
Jeta e tij ishte një poemë,  
Poemë që do të mbetet në përjetësi!

**Paris, 2 May, 2008**

□

**Përzgjedhur dhe përkthyer në shqip nga Jeton Kelmendi**